

Vendim nr. 210 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (L) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **LUIZA SKRAQI, LULZIM SKRAQI**

OBJEKTI: Shpalljen të pavlefshëm dhe urdhërimi e çregjistrimit të pasurisë nr. 11/44 regjistruar në datën 07.12.2014, e llojit truall plus ndërtesë në emër të qytetarit K.S., lëshuar nga ZVRPP-ja Lushnjë si të paligjshme sipas dy vendimeve të Prokurorisë Lushnjë dhe shpalljen të pavlefshme të lejes së ndërtimit nr. 12, datë 12.05.2005 të KRT-së, Bashkia Lushnjë.

Urdhërimin e lirimit të banesës në veri, ndërtim ngjitur dhe truallit në pronësi të veçantë të Luiza Skraqit, fituar me akt dhurimi numri 792, i aktit noterial në datën 10.06.1994 me bazë pjesëtimin e pasurisë me vendim gjykate nr. 136, datë 26.04.1975 dhuruar nga T.P., regjistruar në hipotekë me nr. 384, datë 10.06.1994 të pushtuar nga qytetari K.S., pushtim i vërtetuar nga dy vendime të Prokurorisë Lushnjë, me vendimin nr. 428, datë 09.12.2014 dhe me vendimin nr. 68, datë 18.05.2017 regjistruar si kallëzim më 23.01.2017. [T.P., e ëma e Luizës, pronare e vetme e katit të parë, me akt pjesëtimi pasurie nr. 136, datë 26.04.1975, me këto kufizime: veri-truall i B.C. (tani S.H., pushtuar nga S. me ndërtim ngjitur me banesën e Luizës); jug – rruga nacionale; lindje shtëpia e N.M., ndërtim ngjitur me banesën e Luizës; perëndim – rruga

Lagje (pushtuar nga K.S. me ndërtim me bazë truallin e tjetërsuar nga hipoteka)].

Zhdëmtimin e familjes së Luiza dhe Lulzim Skraqit me 60 mijë euro dëm pasuror dhe 100 mijë euro dëm jopasuror, për privim nga mundësitë e jetës dhe pasurisë, dëmtim i shëndetit me terror për 30 vjet.

Shpalljen të pavlefshme të të gjitha akteve të pronësisë të prodhuara nga vërtetimi i faktit të qytetarit S.P. sipas vendimit nr. 415, datë 21.03.1994 të Gjykatës Lushnjë dhe urdhërimin e çregjistrimit, fshirjes së hipotekës nga ZVRPP-ja, Lushnjë mbështetur në : - vendimin e parë nr. 428, datë 09.12.2014 të Prokurorisë, ku Prokuroria ka konstatuar se në kushte të tilla konstatojmë elemente të veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal (faqja 4 e këtij vendimi). Prokuroria ka vërtetuar se të gjitha aktet që burojnë nga vërtetimi i faktit janë marrë në kushtet e falsifikimit të dokumenteve edhe të shpërdorimit të detyrës. Mbështetur në vendimin nr. 68, datë 18.05.2017, prokuroria thekson se ka konstatuar se në regjistrimin e pronësisë në vitin 2000 nga shtetasi S.P. e më pas në regjistrimin e kalimin e pronësisë shtetasit K.S., nuk janë marrë parasysh origjina e pronësisë së truallit dhe as vendimi nr. 1601, datë 06.11.1995, i cili deklaronte të pavlefshëm regjistrimin hipotekor të S.P., ndërkohë që ky detyrim rëndonte mbi ZVRPP-në, Lushnjë e cila ka shpërdoruar detyrën që në momentin që ka regjistruar në pronësi të shtetasit K.S. 140 m² truall, fakt ky i konstatuar edhe në vendimin e parë të prokurorisë nr. 458, datë 09.12.2014.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, pika 2, 42 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Luiza e Lulëzim Skraqi janë në konflikt pronësie me xhaxhain e kërkueses, shtetasin S.P., lidhur me një banesë dykatëshe të ndërtuar në vitet '70. Me vendimin nr. 136, datë 26.04.1975 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë është bërë pjesëtimi i pasurisë, kati i parë i banesës, mes prindërve të divorcuar të kërkueses, duke iu lënë në pronësi nënës së saj T.P., e cila në vitin 1994 ia ka dhuruar kërkueses.

2. Në vijim, mbi kërkesën e shtetasit S.P. dhe bashkëshortes së tij H.P., Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr. 415, datë 21.03.1994, ka vendosur vërtetimin e faktit të pronësisë së tyre për banesën dykatëshe. Duke pretenduar pavlefshmërinë e veprimeve juridike (vërtetimit të faktit), për shkak se ky vendim është marrë pa dijeninë e bashkëpronarëve T.P. dhe kërkuesve, këta të fundit i janë drejtuar gjykatës me padi për pushimin e cenimit dhe pavlefshmërinë e veprimeve juridike.

3. Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr. 226, datë 15.02.1995, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesve, por ky vendim është prishur dhe çështja i është kthyer asaj për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Lushnjë, me vendimin nr. 1601, datë 06.11.1995, ka pranuar padinë pjesërisht, vetëm për sa i takon pavlefshmërisë së vërtetimit hipotekor për një dhomë, duke rrëzuar pjesën tjetër të saj. Mbi ankimin e kërkuesve Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 907, datë 16.02.1996, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, ndërkohë që vendimi i gjykatës së apelit, në vijim, është lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. 1757, datë 30.10.1996.

4. Në datën 20.01.2014, me pretendimin se regjistrimi i pasurisë objekt konflikti në emër të shtetasve S.P. dhe H.P. është bërë vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor deklarativ, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) duke kërkuar prishjen e vendimeve

nr. 415, datë 21.03.1994 dhe nr. 1601, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë. Me vendimin nr. 29, datë 07.02.2014, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesit nuk kanë respektuar afatin 2-vjeçar të ankimit, të parashikuar në ligjin organik të kësaj Gjykate, si edhe nuk kanë shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

5. Në datën 18.03.2014 kërkuesit i janë drejtuar sërish Gjykatës për rishikimin e vendimit të saj nr. 29, datë 07.02.2014, duke kërkuar edhe prishjen e të njëjtave vendime si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Edhe në këtë rast, me vendimin nr. 82, datë 11.04.2014, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë shkak të ri apo argument shtesë për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve të tyre për cenimin e së drejtës së pronës private nëpërmjet një procesi të parregullt ligjor.

6. Paralelisht me kërkesat drejtuar Gjykatës, në datën 10.02.2014 kërkuesit kanë vënë në lëvizje një proces gjyqësor për interpretimin e vendimit nr. 1601, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë, duke kërkuar saktësimin e dhomës për të cilën është përcaktuar pavlefshmëria e vërtetimit hipotekor. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 558 (64-2014-1382), datë 22.09.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesit, duke arsyetuar se kërkesa për interpretimin e vendimit gjyqësor mund të paraqitet deri sa vendimi nuk është ekzekutuar, ndërkohë që në rastin konkret vendimi rezultonte i ekzekutuar. Për pretendimet e tjera të kërkuesve, ajo gjykatë është shprehur se nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ligjshmëria e vendimit objekt interpretimi mund të kontrollohet vetëm nga gjykatat më të larta. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 23, datë 23.02.2016, ka vendosur lënien në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesit duhej që brenda 30 ditëve nga nxjerrja e vendimit objekt kërkesë të kishin kërkuar plotësimin dhe jo interpretimin e tij, ndërkohë që interpretimi i vendimit nuk mund të kryhej, pasi ishte vënë në ekzekutim. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesit.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-695, datë 17.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ndërsa pretendimeve në rekurs u është dhënë përgjigje shteruese nga gjykata e apelit.

9. Në datën 25.07.2024 (sipas shërbimit postar) kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 07.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuesve

10. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se është cenuar:

10.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, pasi:

10.1.1. Gjykata e ka tjetërsuar këtë pronësi me një vendim deklarativ për vërtetim fakti, vendim i cili është bërë pa dijeninë e kërkuesve, çka përbën një proces të parregullt ligjor, duke iu mohuar atyre origjinën e pronësisë. Me vendimin nr. 1601, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë janë pranuar falsifikime e shpërdorim detyre të organeve të hipotekës e arkivës (të vërtetuara nga Prokuroria Lushnjë). Ky konflikt ka rrezikuar e privuar nga jeta 5 pjesëtarë të familjes së tyre për 30 vjet, ndërkohë që duhej që në fillim, me pjesëtimin e pasurisë, të mos fillonte procesin, sepse përbënte gjë të gjykuar dhe pa asnjë justifikim juridik, krijoi një tjetërsim prone dhe nxitje për tentativë për vetëgjykim.

10.1.2. Gjykata ka dhënë vendime për fitim pasurie me mashtrim, duke tjetërsuar pronësinë banesë dhe truallin në favor të S.P. dhe blerësit të tij K.S.

10.1.3. Gjykata ka dhënë vendim për pushtimin e 200 m² truall, i cili sipas ligjeve të kohës jepej me lejen e ndërtimit, duke u bërë bashkëpunëtore në shkeljen flagrante të ligjit parashikuar nga nenet 200, 348 e 184 të Kodit Penal, ndërkohë që i takonte së ndjerës T.P. dhe sot trashëgimtares Luiza Skraqi.

10.2. *E drejta e pronës*, e parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjeve të paligjshme ndër vite të gjykatave dhe konkretisht të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për një pronë që kërkuesit e kanë fituar me trashëgimi.

10.3. *E drejta për t'u rehabilituar dhe zhdëmtuar*, e parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, si pasojë e dëmit pasuror dhe jopasuror që u ka ardhur atyre si pasojë e humbjes së pronës, për të cilin kërkojnë shpërblim në vlerën 60 000 euro dëm pasuror dhe 100 000 euro dëm jopasuror.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesve

11. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Në këtë këndvështrim, kërkuuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 8, datë 03.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuuesit, ndër të tjera, kundërshtojnë regjistrimin e pronës në favor të S.P. sipas vendimet nr. 415, datë 21.03.1994 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë, si dhe vendimin nr. 1601, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë, i cili ka vendosur mbi themelin e çështjes, proces ky që është përmbyllur me vendimin nr. 1757, datë 30.10.1996 të Gjykatës së Kasacionit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se lidhur me pretendimet për këtë proces gjyqësor, kërkuuesit i kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese.

15. Gjithashtu, Kolegji evidenton se kërkuuesit në ankimin kushtetues kundërshtojnë edhe vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2024-695, datë 17.01.2024 që ka vendosur

mospranimin e rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, me të cilin ishte vendosur rrëzimi i kërkesës për interpretimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për sa i takon këtij lloj vendimi, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se për nga natyra dhe qëllimi, ky lloj vendimi i bashkohet si pjesë përbërëse vendimit përfundimtar që ka disponuar për pushimin e cenimit dhe pavlefshmërinë e veprimeve juridike (*shih vendimin nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në kushtet kur procesi gjyqësor ka përfunduar dhe kërkuessit kanë shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, Kolegji çmon se ata e kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk kanë më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, të pretenduara si të cenuara.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga ankimi kushtetues i paraqitur nga kërkuessit, Kolegji konstaton se pavarësisht se në objekt kërkohet, ndër të tjera, shfuqizimi i akteve të pronësisë për pronën objekt konflikti në favor të shtetasit S.P., në thelb kërkuessit kundërshtojnë vendimet nr. 415, datë 21.03.1994 dhe nr. 1601, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë. Gjithashtu, kërkuessit ngrenë pretendime edhe për vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin lidhur me kërkesën për interpretimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për sa u takon pretendimeve që lidhen me procesin e themelit, Kolegji çmon se kërkuessit janë jashtë afatit ligjor për shqyrtimin e tyre nga Gjykata. Ndërsa, lidhur me vendimin nr. 00-2024-695, datë 17.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se ai është bërë i disponueshëm për palët në datën 20.03.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 25.07.2024, sipas shërbimit postar, pra brenda afati ligjor 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për t’u rehabilituar dhe zhdëmtuar, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji do të mbajë në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkuessit

lidhen tërësisht me procesin gjyqësor të zhvilluar, ndaj, për rrjedhojë, çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës.

19. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Lidhur me këtë pretendim, konstatohet se kërkuesit ka dhënë argumente të natyrës ligjore, pa evidentuar se cila e drejtë ose parim konkret që lidhet me të drejtën për proces të rregullt ligjor i është cenuar nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme në procesin objekt shqyrtimi të ankimit kushtetues individual dhe në çfarë mënyre. Për sa më sipër, në kushtet kur pretendimi i kërkuesit nuk është argumentuar në nivel kushtetues, ai nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës së pronës të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjeve të paligjshme ndër vite të gjykatave dhe konkretisht të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për një pronë që kërkuesit e kanë fituar me trashëgimi. Kolegji evidenton se ky pretendim i kërkuesve nga mënyra si është parashtruar lidhet me procesin gjyqësor të zhvilluar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për interpretimin e vendimit nr. 1601, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë të dhënë për themelin e çështjes. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme në aspektin kushtetues për cenimin e procesit të rregullt ligjor të zhvilluar ndaj tyre, që do të sillte si pasojë edhe cenimin e së drejtës së pronës. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Lidhur me dëmshpërblimin e kërkuar nga kërkuesit në vlerën 60 000 euro dëm pasuror dhe 100 000 euro dëm jopasuror, Kolegji vlerëson se ky lloj pretendimi është jashtë juridiksionit kushtetues, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

22. Në kontekst të sa është trajtuar më sipër, Kolegji çmon se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materiae*.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesve nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.